



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
NR 16 DATË 28.02.2022

**MBI MIRATIMIN PËR SHITESË BUXHETI NË MASËN 22,902,36 LEKË E PËRBËRË
NGA TË ARDHURA LOKALE GRANT GRANT SPECIFIK DHE DONACIONE NË
BASHKINË DIMAL PËR VITIN 2022**

Këshilli Bashkiak Dimal në mbledhjen e tij të datës 28.02.2022, bazuar në materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8 pika 2, 9 pika 1.1.b, Neni 25, Neni 34, Neni 35, Neni 36, Neni 37, Neni 40, Neni 41, Neni 53, Neni 54 pika dh, Neni 55, Neni 64 pika c, Ligji nr.68/2017 “Për Financat e vetëqeverisjes Vendore”, neni 45, Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 44, në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat standard të zbatimit të buxhetit” si dhe Udhëzimit plotësues “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, Aktit Normativ nr. 26 Dt. 23.06.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 137/2020 “Për Buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, VKB Nr 82 datë 24.12.2021” Për miratimin e buxhetit afatmesëm 2022-2024 dhe miratimin e Buxhetit të detajuar për vitin 2022” dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë si dhe në informacionin e paraqitur nga drejtoria e Financës dhe Ekonomisë mbështetur në shkresën e MFE për shtesë buxheti për vitin 2022 nga “Ndarja e të ardhurave Akt-Trashëgiminë për vitin 2021 midis bashkisë Ura Vajgurore dhe degës së Thesarit Berat.

VENDOSI

Me 14 vota PRO dhe 1 votë ABSTENIM nga 15 Këshilltarë prezentë në mbledhje të miratojë:

I. Të miratojë shtesë buxheti për vitin 2022 në masën 22,902,365 lekë e përbërë nga të ardhura lokale, grant, grant specifik dhe donacione.

A .	Të ardhurat lokale	Kapitulli	5	=	8,825,892	lekë
B .	Grant i pakushtëzuar	Kapitulli	1	=	6,426,647	lekë
C .	Transferta Specifike	Kapitulli	1	=	7,196,045	lekë
D .	Donacion U N D P	Kapitulli	6	=	453,781	lekë

II. Të miratojë përdorimin e të ardhurave shtesë në masën 22,902,365 lekë si më poshtë :

1. Investime në programin 04520 : 00 : 05 : 231 = 8,825,892 lekë
2. Investime në programin 04520 : 00 : 01 : 231 = 5,374,108 lekë për objektin : (RIKONSTRUKSION URBAN I LAGJES 4 SHTATORI)

3. Investime në programin 06330 : 00 : 01 : 231 = 1,200,000 lekë për objektin :(RRJETI I SHPËRNDARJES NË LAGJEN 18 TETORI DHE BISTROVICË)

4. Shpenz. Operative për mirëmbajtje të “WEB GIS BASHKIA DIMAL” 01110:
00:01:601=1,320,000 lekë”

5. Shpenzime operative në programin 04520 : 00 : 01 : 602 = 520,000lekë

6. Shpenzime operative në programin 03280 : 00 : 01 : 602 = 408,584 lekë

7. Shpenzime operative në programin 09120 : 00 : 01 : 600 = 1,700,000 lek

8. Shpenzime për investime 09120 : 00 : 01 : 231 = 3,100,000 lekë

Për likuidimin e objektit “ Ndërtim kopështe në lagjen 28Nëntori , 4 Shtatori , dhe Syzes”
Shuma e donacionit nga UNDP prej 453,781 lekë të përdoret

9. Programia 10140 00 : 06 : 602 = 453,781 lekë

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Hysen Hoxha

